



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 710/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Furnizim vendosje paisje për kopshte, çerdhe dhe shkolla*”, me nr. REF-24421-05-29-2019, me fond limit 23,564,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Kastriotët”, ndërtesë me z.k. 2679, Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k.
Adresa: Komuna Xhafzotaj, pranë kryqezimit “4 Rrugët”, Durrës.
- Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.05.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Furnizim vendosje paisje për kopshte, çerdhe dhe shkolla*”, me nr. REF-24421-05-29-2019, me fond limit 23,564,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2 Në datën 10.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.07.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------|------------------------------------|
| 1. “Emko” sh.p.k. | 18,928,000 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Al - Asfalt” sh.p.k. | 20,659,800 lekë, Skualifikuar; |
| 3. “Bolt” sh.p.k. | 23,360,700 lekë, Kualifikuar; |
| 4. “M. Lezha” sh.p.k. | 23,459,700 lekë, Kualifikuar; |
| 5. “Shaga.” sh.p.k. | 23,558,120 lekë, Kualifikuar; |
| 6. “Ro - Al” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |
| 7. “Muca” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |

II.4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisioni të Prokurimit Publik, rezulton se, në datën 02.08.2019, operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ankesë e cila është pranuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

II.5. Në datën 13.08.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Emko” sh.p.k.	18,928,000 lekë, Skualifikuar;
2. “Al - Asfalt” sh.p.k.	20,659,800 lekë, Kualifikuar;
3. “Bolt” sh.p.k.	23,360,700 lekë, Kualifikuar;
4. “M. Lezha” sh.p.k.	23,459,700 lekë, Kualifikuar;
5. “Shaga.” sh.p.k.	23,558,120 lekë, Kualifikuar;
6. “Ro - Al” sh.p.k.	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;
7. “Muca” sh.p.k.	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;

II.6.Në datën 19.08.2019, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për rikualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 7669/2 Prot. datë 20.08.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

”[...] Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik BOLT shpk se operatori ekonomik AL-Asfalt shpk nuk disponon certifikatat ISO, të kërkuara në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” në DT, nuk qëndron, pasi ky operator ka depozituar në sistemin elektronik të APP të gjithë dokumentacionin e kërkuar përfshirë edhe ISO-t specifikuar në të. Njëkohësisht ankuesi pretendon se: nisur nga objekti që ka ky operator ekonomik asnjë nga certifikatat ISO nuk i ka me objektin për të cilën është procedura e prokurimit, dmth “prodhim tregtim mobilje”. Ky pretendim nuk qëndron sepse në fakt, objekti i prokurimit nuk është “Prodhim, tregtim mobilje”? por “Furnizim vendosje pajisje për kopshte, çerdhe dhe shkolla”. Lidhur me pretendimin e mësipërm , Ju sjellim në vëmendje Vendimin e KPP Nr. 28/2018 me protokoll Nr. 1901 datë 28.12.2017, ku ndër të tjera shprehet(citim..)

Gjithashtu, nga verifikimi i DT, në asnjë rast nuk rezulton të jetë kërkuar nga Autoriteti kontraktor, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë të jenë domosdoshmërisht prodhues të mobiljeve, objekt prokurimi. Kjo presupozon që realizimi i kontratës mund të përmbushet edhe nëpërmjet operatarëve ekonomikë që kanë si objekt veprimtarie tregtim të artikujve industrialë. Përsa i përket referimit tuaj në Vendimin e KPP Nr. 712/2018, që ka si objekt prokurimi “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë Rruga “Nyja F.Dukagjin-L. Rr.Kombit, U.Drinit (hyrja Kukës)-Sh.Galica, Sh.Galica-Krumë, Krumë-Q.Prushi, Plepa-Kam etj..., ”, jemi të mendimit që ky objekt është specifik, pasi presupozon një sipërmarrje të një rëndësie të veçantë dhe nuk mund të krahasohet me objektin e prokurimit “Furnizim vendosje pajisje për kopshte, çerdhe

dhe shkolla” i cili mund të përmbushet lehtësisht edhe nga operatorë që kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtimin e artikujve industrialë. Referuar nenit 55 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pas rivlerësimit është klasifikuar në vendin e parë oferta e vlefshme më e ulët e paraqitur nga operatori ekonomik AL-Asfalt shpk me vlerë të ofertës 20’659’800 lekë, në respektim të kriterit ligjor primar të përcaktuar qartë në ligjin e prokurimit publik (oferta ekonomikisht më e favorshme). Ju bëjmë me dije se klasifikimi në vendin e parë të operatorit ekonomik AL-Asfalt shpk i kursen institucionit tonë nga fondet publike nje vlerë të përafërt me 2’700’000 lekë [...]”

II.8.Në datën 27.08.2019, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]A.2-Në pikën 3.1 të shtojcës 8, “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor kërkon që “-Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar ma Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”.

A.3 Duke pare ekstraktin ne QKB kemi:

Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e objekteve civile, turistike, shëndetësore, shoqërore, kulturore, tregtare, sportive, industriale, veshje fasada, vepra kullimi dhe infrastrukture, shërbime komunale, rrugë, ura, punime bonifikimi, etj. Projektimi i objekteve të sipërcituara, asistencë, mbikqyrje dhe ekspertizë teknike. Nxjerrjen, përpunimin e prodhim të gurit, materialeve inerte në përgjithësi. Prodhimin e elementëve të betonit, betonarme të zakonshme e prodhimin e materialeve të ndërtimit në përgjithësi. Tregtimi me shumicë e pakicë i materialeve të ndërtimit të tullave e tjegullave, bojgrave, materialeve hidraulike dhe termike, pllakave, tubave, etj. Prodhim Asfalto-Beton. Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i makinerive, artikujve industrial e të ndërtimit. Çelja dhe ndërtimi i strukturave të tilla si supermaketeve, bar, restorant, hoteleri, ofiçinë, lavazh, servis automjetesh, etj. Prodhim dhe tregtim apo importim dhe eksportim të duraluminit lëndë e parë dhe lëndë e papërpunuar si dyer, dritare, vetrata, grila dhe aksesoret e tyre, etj. Për projektim: Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe. Për zbatim: Punime në sipërfaqet e gjelbërta, parqe-pyll, parqe, pastrimi i sipërfaqeve urbane, kryerja e punimeve në varrezat publike dhe të dëshmorëve, zhvillimin e dekorit në mjedise urbane. Për kolaudim shërbimi: Punime në sipërfaqet e gjelbërta urbane, parqe-pyll, parqe, punime shërbimi-pastrimi i ambjenteve urbane, punime në varrezat publike dhe të dëshmorëve, zhvillimit të dekorit urban. Import-Eksport të produkteve ushqimore, blegtorale dhe të shitjes me shumicë e pakicë të këtyre produkteve. Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerële jo metalike. Prodhim dhe përpunimi i inerteve dhe rikuperimi i mbetjeve inerte.

Ne asnje rrjesht te ekstraktit nuk kemi prodhim apo tregtetim mobiljesh apo paisje shkollore. Dhe tregtimi i artikujveve industrial eshte nje ze i paperfillshem ne elementet perberes te produkteve object te kesaj kontrate.

A.4 Lidhur me nje praktike te tille KPP ne vendimin 712/2018(bashkngjitur) shprehet qarte(citim...)

B.1Ne DST, kerkesat per kualifikim, pika 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë, pika 2.3 kapaciteti teknik kerkohen: g Kërkohet certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë h-Kërkohet certifikatë ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit j-Kërkohet certifikate OHSAS 18001 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë i-Kërkohet

çertifikatë BS PAS 99:2012 për sistemin e integruar të menaxhimit k-Kërkohet çertifikate EN-ISO 3834 e përditësuar për sistemin e menaxhimit të prodhimit/tregtimit të mobiljeve metalike apo pjesë përbërëse të tyre

B.2-Nisur nga objekti që ka ky operator ekonomik asnjë nga certifikatat e mesiperme nuk i ka me objektin për të cilën është procedura e prokurimit, dmth prodhim tregtim mobilje. B.3-Ne mënyrë të vecantë piken k)çertifikate EN-ISO 3834 e përditësuar për sistemin e menaxhimit të prodhimit/tregtimit të mobiljeve metalike apo pjesë përbërëse të tyre ky operator ekonomik nuk e ka paraqitur me këtë emertese të kërkuar në DST. Pretendimi i Autoritetit Kontraktor se Operatori Ekonomik ka paraqitur këtë certifikatë në lidhje me objektin e prokurimit bie ndesh me qëllimin që kërkohet “për prodhim/tregtim mobilje metalike” dhe s’ka lidhje asgjekundi me paisje apo artikuj industrial.

B.4-Ne gjykimin tonë ky operator ekonomik nuk i plotëson këtë kërkesë për kualifikim.

C.1-Ne ankesën që ky operator ekonomik të hedhur në faqen e APP në lidhje me aktivitetin e tij sqaron se nuk është prodhues dhe një gjë e tillë nuk është kërkuar as nga AK, si dhe nuk kërkohet dhe autorizim prodhuesi.

C.2-Ne DST në njoftimin e kontratës në pikën 2.14.1 theksohet të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo X

Pra nuk lejohet në kontraktimi. Me të drejtë shtrojmë pyetjen si do të realizoj këto procedura prokurimi ky operator ekonomik? Kur prodhues nuk është, importues nuk është? Pra me N/kontraktim në masën 100%. Gjithashtu dhe oferta e dhënë prej tij është e pastudiuar mirë për të gjitha produktet objekt të kësaj procedure e cila nuk premtim dhe furnizim cilësor me këto produkte, pasi një pjesë e këtyre produkteve janë të natyrës industriale dhe jo produkte familjare. Një ofertë e pastudiuar në detaj sic kërkohen në specifikimet teknike. [...]”

II.9.Në datën 06.09.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.13948/1prot., datë 04.09.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k. me argumentin: “[...]Ne asnjë rrjesht të ekstraktit nuk kemi prodhim apo tregtim mobiljesh apo paisje shkollore. Dhe tregtimi i artikujve industrial është një zë i paperfillshëm në elementet perberes të produkteve objekt të kësaj kontrate. B.1Ne DST, kërkesat për kualifikim, pika 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë, pika 2.3 kapaciteti teknik kërkohen: g Kërkohet çertifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë h-Kërkohet çertifikatë ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit j-Kërkohet çertifikate OHSAS 18001 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë i-Kërkohet çertifikatë BS PAS 99:2012 për sistemin e integruar të menaxhimit k-Kërkohet çertifikate EN-ISO

3834 e përditësuar për sistemin e menaxhimit të prodhimit/tregtimit të mobiljeve metalike apo pjesë përbërëse të tyre B.2-Nisur nga objekti që ka ky operator ekonomik asnjë nga certifikatat e mesiperme nuk i ka me objektin për të cilin është procedura e prokurimit, dmth prodhim tregëtim mobilje. B.3-Ne menyre të vecante piken k)çertifikate EN-ISO 3834 e përditësuar për sistemin e menaxhimit të prodhimit/tregtimit të mobiljeve metalike apo pjesë përbërëse të tyre ky operator ekonomik nuk e ka paraqitur me këte emertese të kerkuar në DST. Pretendimi i Autoritetit Kontraktor se Operatori Ekonomik ka paraqitur këte certificate në lidhje me objektin e prokurimit bie ndesh me cilesimin që kerkohet “për prodhim/tregëtim mobilje metalike” dhe ska lidhje asgjekundi me paisje apo artikuj industrial [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

III.1.2. Në shtojcën 9, pika 2.3, gërmat g; h; i; j; k, “Për kapacitetin teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“g.Kërkohe certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë

h.Kërkohe certifikatë ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit

i. Kërkohe certifikate OHSAS 18001 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë

j. Kërkohe certifikatë BS PAS 99:2012 për sistemin e integruar të menaxhimit

k. Kërkohe certifikate EN-ISO 3834 e përditësuar për sistemin e menaxhimit të prodhimit/tregtimit të mobiljeve metalike apo pjesë përbërëse të tyre”

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Al - Asphalt” sh.p.k. në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar respektivisht dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” lëshuar më 28.05.2019, nga ku rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Al - Asphalt” sh.p.k. është si vijon: “Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e objekteve civile, turistike, shëndetësore, shoqërore, kulturore, tregëtare, sportive, industriale, veshje fasada, vepra kullimi dhe infrastrukture, shërbime komunale, rrugë, ura, punime bonifikimi, etj. Projektimi i objekteve të sipërcituara, asistencë, mbikqyrje dhe ekspertizë teknike. Nxjerrjen, përpunimin e prodhim të gurit, materialeve inerte në përgjithësi. Prodhimin e elementëve të betonit, betonarme të zakonshme e prodhimin e materialeve të ndërtimit në përgjithësi. Tregëtimi me shumicë e pakicë i materialeve të ndërtimit të tullave e tjegullave, bojrave,

materialeve hidraulike dhe termike, pllakave, tubave, etj. Prodhim Asfalto-Beton. Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i makinerive, artikujve industrial e të ndërtimit. Çelja dhe ndërtimi i strukturave të tilla si supermaketeve, bar, restorant, hoteleri, oficinë, lavazh, servis automjetesh, etj. Prodhim dhe tregtim apo importim dhe eksportim të duraluminit lëndë e parë dhe lëndë e papërpunuar si dyer, dritare, vetrata, grila dhe aksesorët e tyre, etj. Për projektim: Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe. Për zbatim: Punime në sipërfaqet e gjelbërta, parqepyll, parqe, pastrimi i sipërfaqeve urbane, kryerja e punimeve në varrezat publike dhe të dëshmorëve, zhvillimin e dekorit në mjedise urbane. Për kolaudim shërbimi: Punime në sipërfaqet e gjelbërta urbane, parqe-pyll, parqe, punime shërbimi-pastrimi i ambjenteve urbane, punime në varrezat publike dhe të dëshmorëve, zhvillimit të dekorit urban. Import-Eksport të produkteve ushqimore, blegtorale dhe të shitjes me shumicë e pakicë të këtyre produkteve. Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike. Prodhim dhe përpunimi i inerteve dhe rikuperimi i mbetjeve inerte”

- Certifikatë EN ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë
- Certifikatë EN ISO 14001:2015 për sistemin menaxhimit të mjedisit
- Certifikate BS OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë
- Certifikatë BS PAS 99:2012 për sistemin e integruar të menaxhimit
- Certifikate UNI EN-ISO 3834-2:2006 kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike
- Certifikatë ISO 50001:2011 për sistemin e menaxhimit të energjisë
- Certifikatë ISO/IEC 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë së informacionit
- Certifikatë BS ISO 39001:2012 për sigurinë në trafikun rrugor

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.5. Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

1. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konkretisht në shtojcën 9 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “*Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit*”, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të kenë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k., rezulton se ky i fundit, ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, ku konstatohet se nuk ka të pasqyruar si objekt aktiviteti prodhimin apo tregtimin e mallrave objekt i kësaj procedure prokurimi, ashtu siç është kërkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k. nuk plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë, në fushën e prodhimit apo tregtimit të mallrave objekt i kësaj procedure prokurimi, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor dhe sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.1.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, mbi objektin e veprimtarisë të certifikatave të cilësisë, të paraqitura nga operatori ekonomik “Al - Asfalt” sh.p.k., Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001, BS PAS 99:2012, EN-ISO 3834. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “Al - Asfalt” sh.p.k., ndër të tjera, për të vërtetuar se kryen aktivitetin e tij sipas standarteve, ka paraqitur certifikatat e mësipërme, lëshuar nga organizimi certifikues AQSCert.

III.1.8.Nga shqyrtimi i këtyre certifikatave, rezulton se operatori ekonomik ankimues është certifikuar për për aktivitetet *“Ndërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve civile dhe industriale, rrugëve dhe infrastrukturë rrugore, urave, veprave kulluese dhe punime bonifikimi, ujësjellësive, kanalizimeve, etj. Prodhimi i betonit, asfaltbetonit. Tregëtim të materialeve të ndërtimit, tullave, tjegullave me shumicë e pakicë. Punime në sipërfaqet e gjelbërta urbane, parqe-pyll, parqe punime. Shërbimi-pastrimi i ambjenteve urbane. Punime në varrezat publike dhe të dëshmorëve dhe të zhvillimit të dekorit urban”*. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të vërtetojë se kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve të cilësisë, pasi me anë të certifikatave të sipërcituara, ankimuesi vërteton se është i certifikuar për cilësinë e sipas standarteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për shërbimet/punët/mallrat e sipërcituara, të cilat referuar kodeve EA sipas dokumentit udhëzues të Organizmit European të Akreditimit, që bazohen në aneksin 1, të rishikimit 2, të *“NACE- National Classifications of Economic Activities”* (Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve Ekonomike), miratuar në Rregulloren (EC) të Parlamentit European nr.1893/2006, janë aktivitete totalisht të ndryshme me objektin e prokurimit dhe me kode EA të vecanta. Referuar në udhëzimet dhe manualët e organizmave të akreditimit si EA dhe IAF, Komisioni gjykon se në certifikatën e lëshuar për subjektin duhet specifikuar domosdoshmërisht aktiviteti konkret për të cilin subjekti përmbush standartin, pasi për certifikimin e një subjekti në një apo më shumë standarte, organizmat certifikuese janë të detyruara të kryejnë auditimet përkatëse të cilat janë specifike sipas fushës së veprimtarisë. Vlen të theksohet, se operatorët ekonomikë duhet të jenë të certifikuar mbi standartet e cilësisë në fushën e veprimtarisë objekt prokurimi, pasi certifikimi në fusha veprimtarie të tjera e bën vendosjen e kriterit të vecantë të kualifikimit dhe paraqitjen e certifikatave të pakuptimë.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik *“Al Asfalt”* sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Bolt”* sh.p.k. qëndrojnë.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues *”Bolt”* sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik *“Al - Asfalt”* sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë pasi operatori ekonomik *“Al - Asfalt”* sh.p.k nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Furnizim vendosje paisje për kopshte, çerdhe dhe shkolla*”, me nr. REF-24421-05-29-2019, me fond limit 23,564,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e operatorit ekonomik “Al Asfalt” sh.p.k., si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1435 protokoli Datë 27.08.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha